



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/12 Nr. i faq./Br.str/No.pg 78

Data/Datum/Date 27 / 01 / 2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenit 51 paragrafi 51.2 dhe nenit 73, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34, 35, 36 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizara

- Me këtë vendim **formohet** komisioni përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizara, në këtë përbërje:
 - 1.1. Florida Bajraktari**, anëtar/e e Kuvendit – AAK;
 - 1.2. Merisa Sharku**, anëtar/e e Kuvendit – VV;
 - 1.3. Lirigzon Kastrati**, anëtar/e e Kuvendit – LDK;
 - 1.4. Besmire Bytyqi**, anëtar/e e ekzekutivit
 - 1.5. Vjollca Gurgule**, anëtar/e e shoqërisë civile.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.12/25

Me datë:31.01.2025

